



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

AKT NORMATIV

Nr. 38, datë 31.12.2020

PËR

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT MINISTRIT TË SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE DHE MINISTRIT TË SHËTETIT  
PËR RINDËRTIMIN PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE  
ME PRODHUESIT E VAKSINËS ANTICOID-19, TË CILËT  
JANË TË CERTIFIKUAR NGA DEPARTAMENTI AMERIKAN  
I USHQIMIT DHE BARNAVE (FDA) DHE/OSE AGJENCIA  
EVROPIANE E BARNAVE (EMA), PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË ME KËTË VAKSINË**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

**Dhënie autorizimi për zhvillimin e negociatave**

Dhënie e autorizimit ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin për zhvillimin e negociatave me prodhuesit e vaksinës Anticoid-19, të cilët janë të certifikuar nga Departamenti Amerikan i Ushqimeve dhe Barnave (FDA) dhe/ose Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me këtë vaksinë, sipas kushteve më të favorshme për Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2**  
**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**MINISTRI SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE**

**OGERTA MANASTIRLIU**

**MINISTRI I SHTETIT  
PËR RINDËRTIMIN**

**ARBEN AHMETAJ**

NR.PROT. 6708/1  
DATE 15.1.2021

KUVENDIT  
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**

